



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 74, Datë 12.03.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15, pika 4 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 879 prot., datë 10.03.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW.
- Në vijim të këtij licencimi, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për saktësim në Aneksin A të licencës së saj, për ndryshimin e numrit të njësive gjeneruese (panelet) dhe vendosjen e pajisjeve të depozitimit të energjisë, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të licencës prej 50 MW.
- Për sa i përket kërkesës së shoqërisë, ERE me e-mailin e datës 06.03.2026, i ka sqaruar shoqërisë dokumentacionin e nevojshëm për të vijuar me shqyrtimin e kësaj kërkeje për disa ndryshime dhe shtesa në Aneksin A të licencës.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e

licencës sipas gërmave (b, d, e, f dhe g) si dhe në datën 06.03.2026, shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.

Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 15, “Modifikimi i Licencës”

Pika 4, *Në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin duke kërkuar informacionin e mëposhtëm.*

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë vendimin me shkrim të organeve drejtuese të saj, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.

Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohen dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 242, datë 03.08.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 MW, për ndryshimin e numrit të paneleve dhe shtimin e objekteve të depozitimit të energjisë në Aneksin A të licencës.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI